



**Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, me nënparagrafin 11 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr.04/L-150 dhe nenit 27 paragrafi 1 me nënparagrafin 11 të Statutit të OSK-së në mbledhjen e mbajtur me 22.12.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

(MBI SJELLJEN DHE STANDARDET E VESHJES SË PUNONJËSVE NË SHËRBIMIN PROFESIONAI)

- I. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e shërbimit profesional duhet të paraqiten në mënyrë korrekte dhe me përgjegjshmëri gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë me palët, kolegët dhe menaxhmentin.
- II. Komunikimi verbal në zyret e OSK nuk duhet të bëhet me zë të lartë, me përdorimin e shprehjeve të papërshtatshme e të pakontrolluara, por duhet të jetë brenda rregullave të etikës.
- III. Në komunikimin e përditshëm brenda zyreve të Odës, punonjësit e shërbimit profesional duhet të respektojnë shkallën hierarkike. Komunikimi, duhet të karakterizohet nga etika dhe respekti i ndërsjellë.
- IV. Punonjësit e shërbimit profesional duhet të kenë kujdes të mos i pengojnë punonjësit tjerë në kryerjen e detyrave të rregullta të punës.
- V. Veshja dhe paraqitja e punonjësve të shërbimit profesional duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin-autoritetin e OSK-së.
- VI. Veshja e punonjësve meshkuj duhet të jetë me kostum, këmishë, kravatë apo ekuivalente. Veshja për punonjëset femra duhet të jetë serioze, jo ekstravagante, pa grim të tepruar dhe pa take të larta.

- VII. Në mënyrë të veçantë gjatë orarit zyrtar është e papranueshme mbajtja e veshjeve të papërshtatshme.
- VIII. Si veshje të papërshtatshme konsiderohen: veshjet dhe mbathjet sportive, veshjet me mbishkrime, minifundet, pantallonat e shkurtra, të zbardhura, të grisura, të ngushta, veshjet të hapura sa të ekspozojnë në mënyrë joetike pjesët e caktuara të trupit ose veshjet e brendshme, të palara, transparente dhe/ose provokative).
- IX. Në rast të mospërfilljes së vërejtjes që i bëhet nga mbikëqyerësi i drejtpërdrejtë dhe vazhdimi të paraqitjes në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, mbikëqyerësi i drejtpërdrejtë i bënë vërejtje me shkrim punonjësit dhe e njehta deponohet në dosjen e tij/sajë personale. Në rast se i njëjti edhe pas vërejtjes me shkrim nga mbikëqyerësi i drejtpërdrejtë nuk sillet konform vendimit në fjalë, atëherë mbikëqyerësi i drejtpërdrejtë e ka të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore pranë komisionit disiplinor.
- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Sekretari i OSK-së.
- XI. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi e bënë kryetari i OSK-së.
- XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

P'ërgohet :

Shërbimit Profesional

Kryesuesi i KD
Prof.Dr. Blerim Kamberi

